



- Të Reja ▾
- Policia e Shtetit ▾
- Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptar
- Shërbime ▾
- Baza ligjore
- Vendndodhjet e policisë
- Video
- Programi i transparencës ▾
- Kontakt
- Denonco Krimin Kibernetik
- Drejtoritë Vendore të Policisë ▾
- Policia Kufitare ▾
- Policia Rrugore ▾
- Donacione
- Rubrika Policimi në Komunitet ▾
- Përmbledhja Javore
- Për sinjalizimin

Breaking News:

Tiranë – Vihen në pranga 8 shtetas

⏏ ⏪ ⏩



08/06/2023

Dibër – Tentoi Të Vriste Me Armë Zjarri, Një Shtetas, Shpallet Në Kërkim

Dibër

Tentoi të vriste me armë zjarri pistoletë, një shtetas pas një konflikti për motive të dobëta, identifikohet 33-vjeçari dhe vijojnë kontrollet për kapjen e tij.

Shpallen në kërkim dhe 3 shtetas të tjerë, pasi ndihmuan 33-vjeçarin të largohej pas ngjarjes.

Vihet në pranga një 30-vjeçar, pasi bashkëpunoi me këta 3 shtetas, për të ndihmuar 33-vjeçarin të largohej, duke e marrë në automjet.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Dibër, pas marrjes së njoftimit se në qytetin e Peshkopisë, një shtetas kishte tentuar të vriste me armë zjarri një shtetas tjetër me të cilin ishte konfliktuar, menjëherë kanë organizuar punën për kapjen e autorit dhe për dokumentimin e rethanave të ngjarjes.

Si rezultat i veprimeve hetimore, shërbimet e Policisë kanë identifikuar dhe shpallur në kërkim shtetasit:

A. A., 33 vjeç, banues në Peshkopi, për veprën penale "Vrasja me dashje", mbetur në tentativë;

K. A., 28 vjeç, I. B., 23 vjeç dhe Xh. K., 20 vjeç, të tre banues në Peshkopi, për veprat penale "Moskallëzimi i krimit" dhe "Përkrahja e autorit të krimit".

Në vijim të veprimeve është arrestuar në flagrancë shtetasi A. M., 30 vjeç, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit".

Nga veprimet hetimore dyshohet se shtetasi A. A., pas një konflikti për motive të dobëta, ka tentuar të vrasë me armë zjarri pistoletë shtetasin S. A., 20 vjeç, banues në Peshkopi.

Pas ngjarjes, shtetasi A. M. (tashmë i arrestuar), së bashku me shtetasit K. A., I. B. dhe Xh. K. (të shpallur në kërkim), kanë ndihmuar shtetasin A. A. që të largohej nga vendi i ngjarjes, duke e marrë në automjetin e tyre.

Vijon krehja e zonës nga shërbimet e Policisë, me qëllim kapjen e shtetasit A. A. dhe të 3 shtetasve të tjerë të shpallur në kërkim.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search

🔍

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month ▾

- Linqe
- >

Arkiva
- >

Akademia e Sigurisë
- >

Ministria e Brendshme
- >

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- >

Interpol
- >

Europol
- >

Misioni PAMECA V
- >

SCPA
- >

Projekti Trivalent

◀ DVP Korçë – Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 2 të tjerë

Raporti ditor i ngjarjeve, 8 qershor 2023 ▶